



KONTRATA SOCIALE ELBASAN

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

DHJETOR 2021-SHTATOR 2022

PUBLIKIMI I DYTË I MONITORIMIT

**PËRGATITUR NGA:
TJETËR VIZION ELBASAN**



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleance Gjimore për Zhvillim



Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra “Aleanca Gjinore per Zhvillim”, Tiranë;
Qendra “Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”, Durrës;
“Qendra Rinore” Vlorë;
“Shoqata për Integrimin e Zonave Informale”, Kamëz;
Qendra “Epoka e Re”, Fier;
“Intelektualët e Rinj Shpresë”, Shkodër;
“Lëvizja Rinore për Demokraci”, Pukë;
“Qendra Rinore për Progres”, Kukës;
“Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim”, Progradec;
“Hapa të Lehtë”, Vau i Dejës;
“Tjetër Vizion”, Elbasan;
“Gruaja në Zhvillim”, Korçë.

Ky Raport është Përgatitur nga Shoqata Tjetër Vizion në kuadër të projektit POP 2022 “Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Tabela Përmbledhëse

SHKURTIME	3
FALENDERIME	4
HYRJE	5
METODOLOGJIA	6
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE	10
VLERËSIM I THELLUAR DHE PËRFUNDIME	12
REKOMANDIME	13
ANEKSE	14

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
GADC	Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillimi”
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
KB	Këshilli Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID - 19	Pandemia e Virusit Korona
AZHRB	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
UKT	Ujësjetës Kanalizime

Falenderime

Për të hartuar Raportin e periudhës dhjetor 2021 – shtator 2022, të monitorimit të Kontratës Sociale, bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Elbasan dhe drejtoritë përkatëse, për vënien në dispozicion të informacioneve të kërkuara; Kryetarin e Bashkisë z. Gledian Llatja, Drejtorin e Shërbimit social të bashkisë z. Ervin Muço për disponibilitetin e tyre në komunikimet e vazhdueshme përgjatë vitit të parë të monitorimit të Kontratës Sociale të Elbasanit.

Falenderojmë në mënyrë të veçantë qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) si edhe një falenderim për stafin dhe vullnetarët e Tjetër Vizion të cilët që prej momentit të nënshkrimit të Kontratës Sociale kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm të punës së Bashkisë dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2021-2022 për të tretin vit me radhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Shoqata Tjetër Vizion u bë pjesë e Rrjetit POP në vitin 2021 duke filluar aktivitetet e saj në muajin Maj 2021.

Forumi për deklarimin dhe nënshkrimin e Kontratës Sociale¹ Elbasan u organizua në datë 30 korrik 2021² dhe u finalizua me firmosjen e saj nga Kryetari i Bashkisë, z. Gledian Llatja, i cili mori përsipër që prioritetet kryesore të pasqyruara në këtë kontratë dhe të dala nga komuniteti i Elbasanit do të jenë përparësi edhe e punës së tij gjatë mandatit deri në vitin 2023 kur do të zhvillohen zgjedhjet e ardhshme lokale.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën **Dhjetor - Shtator 2022**

Gjatë kësaj periudhe organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.
- Te monitorojë median sociale mbi informimin dhe përmbushjen e prioriteteve te
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

¹ Kontrata Sociale Elbasan <https://popnetwork.al/elbasan-kontrata-sociale/>

² Forumi publik dhe firmosja e kontratës

<https://www.facebook.com/groups/344865938888020/posts/6046021025439121/>

Metodologjia

Për të realizuar raportin, Tjetër Vizion, anëtare e rrjetit POP u bazua në hapat e mëposhtëm:

U monitorua puna e Bashkia Elbasan dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën **Janar 2022-Nentor 2022**

Në datën 13 Janar anëtarët e rrjetit POP organizuan mbledhjen e parë për vitin 2022. Qëllimi i këtij takimi të pare online ishte analizimi i punës së vitit që lamë pas dhe arritjet e secilës organizatë në vecanti dhe të Rrjetit POP në përgjithësi.

U analizua një vit sfidues por i mbushur me aktivitete dhe qasje të komunitetit për përfshirje,

- Stafi i shoqatës Tjetër Vizion hartoi raportin paraprak të monitorimit të kontratës Sociale për Bashkinë Elbasan, i cili përfshiu periudhën kohore Janar-Maj 2022.
- Stafi shoqatës Tjetër Vizion në dt 1 Shkurt monitori Mbledhjen e KB si takimi i parë për V. 2022 dhe vendimet e orientimet e bashkisë për këtë vit të ri.
- Stafi i shoqatës Tjetër Vizion ne date 28 Shkurt, 2022³ dhe 19.04, 2022 organizoi dy dëgjesa publike dhe llogaridhënie me qytetarët e NJA nr.1 dhe përfaqësuesit e Bashkisë Elbasan mbi përmbushjen e prioriteteve të kontratës Sociale dhe specifikisht ato të NJA nr 1.
- U koordinua me sekretariatit e këshillit bashkiak për të futur në axhendë diskutimin e kontratës sociale në 04 Mars 2022⁴. Këshilli Bashkiak Elbasan në takimin bëri pjesë të axhendës Kontratën Sociale të firmosur ndërmjet TVO NGO dhe Bashkisë Elbasan. Në takim u prezantuan rezultatet e monitorimit mbi ecurinë për plotësimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për Bashkinë Elbasan dhe u diskutua mbi prioritetet që janë në proces realizimi dhe monitorimi. Gjatë diskutimeve u prekën të pesta çështjet e kontratës sociale, të cilat komuniteti i ka vlerësuar se janë shumë prioritare. Diskutimi u fokusua në mënyrë të veçantë tek 3 prioritetet e realizuara si: ndërtimi i rrugëve rurale, vendosja e koshave të plehrave në zonat rurale ku mungonin dhe vendosja e linjës së shërbimit publik të autobuzëve për njësitë administrative ku mungonin. Nga Këshilli Bashkiak u miratuan 2 prioritetet e kontrates sociale për tu realizuar gjatë vitit 2022 si: restaurimi i një shkolle 9-vjeçare dhe rehabilitimi i një rruge dytësore në një lagje periferike të qytetit.
- Në datën 10.02.2022⁵ Shoqata Tjeter Vizion organizoi një përballje me komunitetin e NJA Papër për të informuar dhe monitoruar nga këndvështrimi komunitar përmbushjen e prioriteteve të kontratës sociale për këtë njësi. 2 nga prioritetet e dala nga komuniteti i kësaj njësie si përmirësimi i shërbimit të pastrimit dhe shtimi i koshave të plehrave si dhe vendosja e urbanit për komunitetin që udhëton nga njësia në Elbasan dhe e

³ Takim me komunitetin NJ.A. 1 Elbasan

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=2334565566685292&set=pcb.2334566016685247>

⁴ Prezantimi pranë Këshillit Bashkiak

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=2340028486139000&set=pcb.2340028706138978>

⁵ Takim në Papër <https://www.facebook.com/photo/?fbid=2342701159205066&set=pcb.2342701562538359>

kundërta, rezulton të jenë përmbushur nga bashkia. Gjithsesi ka vend për përmirësim të mëtejshëm brenda këtyre 2 shërbimeve. Rekomandimet e komunitetit ju përcollën Bashkisë Elbasan për t'u përfshirë në axhenden e saj të shërbimeve publike.

- Gjatë gjithë periudhës së raportimit janë shpërndarë fletëpalosje dhe kopje të kontratës sociale të cilat përmbajnë prioritetet e përmbushura dhe ato të pa realizuara. Është nxitur komuniteti në takime që ti marrë në konsideratë të gjitha prioritetet e parealizuara në mënyrë që të ngrëjë zërin dhe nxisë llogaridhënien e pushtetarëve lokale gjatë takimeve që këta të fundit realizojnë me komunitetin.
- Është monitoruar në mënyrë frekvente gjatë gjithë periudhës së raportimit media sociale e Bashkisë Elbasan, media personale e kryebashkiakut Llatja si dhe media TV dhe e shkruar në lidhje me realizimin e prioritetëve dhe çdo formë tjetër premtimi që ata kanë deklaruar të përmbushur. Në fakt vihet re që nuk ka pas fake neës, vetëm deklarime të investimeve të realizuara ose ato që do të fillojnë.
- Shoqata Tjetër Vizion në dt.20.05.2022⁶ ishte në një tjetër përballje me komunitetin e NJA Funar për të informuar dhe monitoruar nga këndvështrimi komunitar përmbushjen e prioritetëve të kontratës sociale për këtë njësi. Një nga prioritetet e dala nga komuniteti i kësaj njësie si rikonstrukcioni i urës që lidh disa fshatra të njësisë rezulton të jetë përmbushur nga bashkia. Gjithsesi pjesëmarrësit në takim vlerësuan punën e bërë nga bashkia dhe ngriten e prioritetëve të reja për tu përfshirë në axhendën e shërbimeve publike të bashkisë. Rekomandimet e komunitetit sidomos për rehabilitimin e rrugës kryesore që lidh bashkinë me NJA i janë përcjellë Bashkisë Elbasan për t'u përfshirë në axhenden e saj të shërbimeve publike.
- Në dt 31 Maj, 2022 ishte planifikuar pjesëmarrja dhe llogaridhënia në mbledhjen e këshillit bashkiak mbi disa investime që do të planifikoheshin në Bashkinë Elbasan, përfshi dhe njësitë që janë përfshirë në kontratën sociale, por ky takim nuk është zhvilluar për shkak të një shtyrje nga ana sekretariatit të KB.
- Në dt.25 Maj 2022 Stafi i Tjetër Vizion merr pjesë në dëgjuesen publike të organizuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja i cili pas disa tureve të konsultimeve publike për Programin Afatmesëm Buxhetor 2023- 2025, me banorë të Njësive Bradashesh, Gracen, Papër, Funar organizoi takimin edhe me përfaqësues të shoqërisë civile në dt 25 Maj. Kryebashkiaku, është ndalur edhe tek investimet e kryera gjatë kësaj periudhe që sipas tij konsistojnë në “ndërrhyrjet me asfaltime në disa zona dhe rrugë dytësore, të cilat janë dhe pjesë e prioriteve të papërmbushura të Kontrates sociale. Përmendim këtu investimet mes pallateve apo urbanizimi i zonës periferike të qytetit siç është edhe Bradasheshi që ka shumë potenciale”, deklaroi kryebashkiaku. Ndërkohë për pjesën e mbetjeve urbane, ai deklaroi se do të fillojë shumë shpejt pastrimi i fshatrave dhe do merren me problematikat që shqetësojnë kryesisht në zonën e Bradasheshit, Labinot Fushë, Shushicës që kanë problem të mëdha përsa i përket mbetjeve dhe pastrimit.
- Bashkia Elbasan po eksperimenton me një projekt të ri, me vendosjen e disa kazanëve ku edhe makinat e pastrimit do merren me pastrimin e zonave rurale.

⁶ Takim në Funar <https://www.facebook.com/photo/?fbid=2403233256485189&set=pcb.2403233536485161>

- Është marrë nën administrim edhe impianti i mbeturinave në Elbasan e cila është një sfidë për bashkinë pasi është një megastrukturë e cila manaxhohet nga Bashkia Elbasan.
- Gjatë monitorimit të vazhdueshëm të Kontratës Sociale, nga Tjetër Vizion është ndjekur hap pas hapi realizimi i prioriteteve të firmosura në kontratë. Pjesa më e madhe e tyre është realizuar. Një nga prioritetet e cila afekton një pjesë të mirë të Rajonit Nr.1 ishte rehabilitimi i rrugës së ish konservimit. Ky prioritet rezultonte i pa bërë deri në fund të Shtatorit 2022. Me qëllim realizimin e këtij prioriteteve Tjetër Vizion filloi një **Fushatë advokuese**. Në fillim ju dërgua një shkresë zyrtare Bashkisë Elbasan në dt.09.09.2022 me nr Prot. 42064/1 dhënie informacioni për të gjitha prioritetet e kontratës sociale, ku theksohej edhe se sa i rëndësishëm ishte fakti i rehabilitimit të rrugës së ish konservimit dhe se sa banorë dhe biznese afektoheshin nga ky rehabilitim. Pas shkresës zyrtare Tjetër Vizion monitoroi buxhetimin me pjesëmarrje tek NjA nr.1 dt.26.10.2022. Gjatë takimit në këtë njësi ky prioritet u ngrit sërish nga banorët duke e vënë në plan të parë nga pikëzimi që mori gjatë takimit. Bashkia u zotua që do e realizonte këtë prioritet gjatë 2 muajve të ardhshëm. Në kuadër të fushatës advokuese Tjetër Vizion nëpërmjet përfaqësueses së saj Zj. Ardiana Kasa thirri në një debat televiziv Bashkinë Elbasan⁷. Në emisionin televiziv të titullur De fakto në dt.27.10.2022 në stacionin lokal televiziv Skampa Zj. Kasa u vu përball N/kryetarit të Bashkisë Z. Guni. Gjatë debatit televiziv u diskutua kontrata sociale, prioritetet e firmosura për tu realizuar nga bashkia, sa ishin realizuar dhe zotimet e bashkisë se kur do të realizoheshin prioritetet e papërbushura. Bashkia nëpërmjet përfaqësuesit të saj u zotua që deri në përfundim të këtij mandati do të realizonte prioritetet e pa përbushura.
- Gjatë muajit Tetor Shoqata Tjetër Vizion ka monitoruar të gjithë procesin e buxhetimit me pjesëmarrje që ka realizuar Bashkia Elbasan. Buxhetimi me pjesëmarrje filloi në Dt. 26.10.2022. Bashkia nëpërmjet një email ftoi të gjithë NGO-të e bashkisë për të qënë pjesë e takimeve jo vetëm si pjesëmarrëse por edhe vëzhguese të këtij procesi. Tjetër Vizion insisitoi dhe ka kërkuar që përveç faktit të pjesëmarrjes në takime të ftoj kryetarin e bashkisë edhe në takime të dedikuara për target grupet në nevojë që ajo përfaqëson. Në këto dëgjesa publike, Bashkia ka dhënë llogari për punën e bërë gjatë një viti në veçanti prioritetet e dala nga takimet e mëparshme dhe niveli i realizimit të tyre si dhe të informoj për të gjitha investimet e realizuara deri tani. Ky proces ka shërbyer jo vetëm si proces llogaridhënie por edhe proces informues për të gjitha llojet e investimeve dhe ndërhyrjeve në bashki. Vlen të përmendet fakti se për shkak të startimit të fushatës zgjedhore lokale në këto takime ka qënë prezent vetë K/bashkisë, i cili i ka dhënë rëndësi informimit dhe promovimit të çdo lloj ndërhyrje të realizuar dhe ato që janë planifikuar në vazhdimësi. Gjithashtu qytetaret prezentë në takime kanë nxjerre prioritetet e reja që shqetësojnë komunitetin. Në fund të takimeve këto prioritete janë votuar dhe ato që kishin pikëzimin më të lartë do jenë pjesë e axhendës së punës për periudhën në vazhdim nga Bashkia Elbasan.
- Shoqata Tjetër Vizion në dt.12.07.2022 ishte në një tjetër përballje me Gra biznesmene (biznese te vogla) për të informuar dhe monitoruar nga këndvështrimi komunitar

⁷ Debatit televiziv: <https://www.youtube.com/watch?v=aLrcNyV5Pek>

përbushjen e prioriteteve të kontratës sociale. Pjesëmarrësit në takim vlerësuan punën e bërë nga bashkia dhe ngriten prioritete të reja për tu përfshirë në axhendën e shërbimeve publike të bashkisë. Rekomandimet e grave biznesmene përsa i përket lehtësirave dhe mbështetjes së biznesit të vogël i janë përcjellë Bashkisë Elbasan për t'u përfshirë në axhenden e saj të shërbimeve publike.

- Shoqata Tjetër Vizion në dt.09.09.2022 ishte në një tjetër përballje me komunitetin e NJA Shirgjan për të informuar dhe monitoruar nga këndvështrimi komunitar përmbushjen e prioriteteve të kontratës sociale për këtë njësi. Një nga prioritetet e dala nga komuniteti i kësaj njësie si furnizimi i vazhdueshëm me uje per vadijtje rezulton të jetë përmbushur nga bashkia. Gjithsesi pjesëmarrësit në takim vlerësuan punën e bërë nga bashkia dhe ngriten prioritete të reja për tu përfshirë në axhendën e shërbimeve publike të bashkisë. Rekomandimet e komunitetit sidomos; hapja e nje kanali vaditës për fashtrat Polis-Tudan dhe rregullimi i defektit në tubat e transmetimit të ujit të pijshëm në zonën Kuqan-Mjekës, i janë përcjellë Bashkisë Elbasan për t'u përfshirë në axhenden e saj të shërbimeve publike.
- Në kuadër të përmbushjes së prioriteteve të Kontratës Sociale Tjetër Vizion në dt.09.09.2022 iu drejtua me një shkresë zyrtare Bashkisë Elbasan për dhënie informacioni lidhur me nivelin e realizimit të këtyre prioriteteve. Bashkia në dt.11.10.2022 ka kthyer përgjigje po me një shkresë zyrtare ku informon lidhur me realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale si dhe informacion shtese për investime të tjera të ndërmarra nga bashkia. Sipas shkresës zyrtare realizimi i prioriteteve të Kontratës Sociale është në nivelin 70% dhe pjesa tjetër prej 30% do realizohet në vijim deri në përmbylljen e mandatit.
- Në dt.10.11.2022 i është dërguar një tjetër shkresë bashkisë, drejtorisë së shërbimit social, nëpunësit të barazisë gjinore. Shkresa konsistonte në një kërkesë për Informacion në lidhje me mos realizimin e 3 prioriteteve të Kontratës Sociale të firmosur në datë 30.07.2021 në lidhje me mos realizimin e 3 prioriteteve ne këndvështrimin gjinor. Shkresa është dërguar dhe aktualisht nuk është marrë ende përgjigje.

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale

Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni i Bashkisë Elbasan

Prioritet 1: Hartimi i njëprojekti dhe më pas financimi për rehabilitimin e rrugës kryesore që lidh bashkinë me njësitë administrative dhe vijimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për secilën njësi.

- **NjA Funar**—Projektimi i rrugës kryesore që lidh njësinë me Bashkinë Elbasan – Nga raportimi dhe monitorimi në terren rezulton se nuk është realizuar ende, por Bashkia në partneritet me OSSH ka vijuar me ndriçimin e qendrës së fshatit dhe disa fshatra të njësisë dhe do vijojë me punimet e kanalizimeve dhe më pas me rikonstruksionin e rrugëve. Gjithashtu në Partneritet me organizatën Tjetër Vizion në kuadër të projektit CBC me bashkinë e Krusevos, (Maqedoni e veriut) do të nxisë dhe investojë për infrastrukturën e turizmit të aventurës duke përfshire shënjimin e rrugëve për ngjitje me tabela treguese, ndërtimin e një zyre informuese turistike për turistët, ndërtimin e sheshit për hedhjen me parashute dhe disa aktivitete të tjera outdoor, të cilat do të nxisin zhvillimin ekonomik të zonës.
- **NjA Funar** - Rikonstruktimi i urës së fshatit – **Rezulton që ndërhyrja është realizuar.**
- **Njësia Administrative Funar** - Projektimi i rrugës kryesore që lidh njësinë me Bashkinë Elbasan- **Rezulton që ndërhyrja nuk është realizuar ende.**
- **NjA Shushicë** - Rikonstruktimi i rrugës së Shelcanit - në dt. 30 Tetor ka përfunduar asfaltimi i rrugës, i cili më pas ka vijuar me vijëzimin dhe vendosjen e sinjalistikës rrugore. Nga monitorimi i zonës, respektivisht në NJ.A të Shushicës u konstatua ndërtimi i shkollës 9- vjeçare të Mlizës; u ndërtua Ura e Polisit si dhe u ngrit Qendra Komunitare Multifunkionale e Shushicës. Këto ishin prioritete të ngritura nga komuniteti i zonës në proceset e mëparshme të buxhetimit me pjesëmarrje.
- **NjA 1 Elbasan** - Pajisja me ndriçim në rrugën kryesore. Gjatë vitit 2022 është vijuar me mirëmbajtjen e ndriçimit ekzistues si riparime, ndërrime ndriçuesish etj.
- **NjA1** - Rehabilitimi i rrugës së ish konservimit. Për këtë rrugë është raportuar nga nën/kryetari i Bashkisë se është bërë studimi dhe planimetria dhe më pas do të fillohet me rehabilitimin e saj gjatë vitit 2022. Në takimin për diskutimin e Planit buxhetor afatmesëm u deklarua se në Shtator të V. 2022 do të vazhdohet me rehabilitimet dhe asfaltimet e rrugëve dytësore, përfshi edhe këtë segment në NJA nr 1. (**aktualisht mbetet prioritet i papërbushur dhe është në fokusin dhe fushatën tonë advokuese**)
- **NjA 1** - Rikonstruktimi i rrugës së varrezave në lagjen Emin Matraxhiu. Nga monitorimi në vend por edhe nga deklarimi i Bashkisë Elbasan rezulton se kjo rrugë ka përfunduar fazën e parë të punimeve, e cila vazhdon të vijojë me fazën e 2të të saj gjatë V.2022.

Prioritet 2. Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për secilën prej njërive vijuese.

- **Në lagjen 28 Nëntori** – Komuniteti i zonës ka deklaruar se ka pallate që kanë 2 ore ujë të pijshëm në dite, kërkohet zgjerimi i fashës së orarit. Koha me furnizim të ujit të pishem ende vazhdon të jetë në të njëjtën frekuencë kohore. Nga komunikimi me specialiste të drejtorisë së UK Elbasan në lagjen 28 Nëntori furnizimi me ujë është me orare si në të gjithë qytetin. Përfshirja e të gjithë pallateve të vjetra në një projekt për pajisjen me kollona jashtë në ambientet e përbashkëta të pajisur me matës dhe me kaseta për çdo klient do të bëjë të mundur rritjen e fashës orare të furnizimit me ujë. Pallatet që do i nënshtrohen këtij projekti janë 4, 5, 6, 9, 108, 108/G, 108/F, 420, 421, 434/1, 421/1, 109, 427, 120/6, 120/5, 120/4, 120/7, 430, 422 /a, b, 108/9 etj. Ky projekt është në fazën e zbatimit të punimeve. Bashkë me këtë projekt po zbatohet edhe projekti i linjave të reja në lagjen e NSHU dhe ndërtimi i depos e stacionit të ri të pompimit. Zgjerimi i fashës orare të furnizimit me ujë do të jetë në kuadër të gjithë qytetit dhe objektivi është 24 orë/24.
- **NJA Funar** – Rikonstrukcioni i shpërndarjes së ujit të pijshëm. Njësia Administrative Funar mbulohet me shërbim nga UK Elbasan. Në Branesh është investuar në rrjetin kryesor nga depo e ujit, është investuar me rrjet shpërndarës dhe instalime kolektorësh dhe matësash uji. Është përmirësuar furnizim me ujë si në lidhje me cilësinë, sasinë dhe orarin e furnizimit.
- **NJA Shirgjan** – Komuniteti ka deklaruar se ka ditë që mungon uji për vaditje, sigurimi në mënyrë të vazhdueshme i ujit për vaditje. Në lidhje me ujitjen dhe problematikat me mungesën e ujit në Njësine Administrative Shirgjan informohet se kjo problematike vjen si pasojë e Teçeve të Librazhdit të cilët bëjnë hapjen dhe mbylljen e ujit dhe kjo sjell oshilacion të prurjeve për ujitje. Bashkia Elbasan ka bërë disa ndërhyrje nëpërmjet Agjencisë së Shërbimeve Publike ku gjatë muajit Maj ka kryer një punë për të vënë në funksion më shumë 6.5 km kanale vaditëse në Shirgjan që i vijnë në funksion 200 fermerëve të gjithë zonës së fushës së Elbasanit. Ky fakt do të jetë prioritet dhe do të ketë vëmendjen e sektorit të Agjencisë së Shërbimeve Publike për vitin 2022.

Prioritet 3. Përmirësimi i cilësisë së pastrimit sipas njërive.

- **NJA Papër** - Mungojnë koshat për grumbullimin e plehrave, vendosja e koshave të plehrave dhe heqja e tyre në mënyrë periodike. Përsa i përket cilësisë së pastrimit për njësine Administrative Papër deklarohet nga përfaqësuesit e bashkisë se me ardhjen e kontenerëve të rinj si dhe me ardhjen e makinave të reja të pastrimit do të bëjnë të mundur shtimin e vendgrumbullimeve dhe pastrimin e tyre në një interval kohor me të shpeshtë, por që situata vijon të jetë e njëjta si më parë.
- **NJA Funar** - Mungojnë koshat e plehrave, kërkohet vendosja e koshave të plehrave dhe heqja e tyre në mënyrë periodike. **Në Njësine Administrative Funar aktualisht nuk**

ofrohet shërbimi i pastrimit për shkak të pamundësisë së futjes së mjeteve për pastrim në një terren të vështirë malor.

- **NJA 1** - Kosha plehrash ka por janë larg vendeve të banimit, të bëhet heqja e plehrave në mënyrë periodike. Drejtoria e shërbimeve publike na ka sqaruar se vendosja e kontenerëve të mbetjeve urbane është bërë sipas studimit dhe projektimit nga Bashkia Elbasan, dhe për heqjen e plehrave në mënyrë periodike merren dhe do të merren masat e duhura.
- **NJA 1** - Të zgjidhet problemi i pastrimit ditët e festave, pasi punëtorët nuk pastrojnë dhe rritet ndotja. Ky problem është zgjidhur tashmë dhe qyteti pastrohet në kohë edhe në ditë festash me nënshkrimin e kontratës së re me kompaninë e zgjedhur në fillim të Janarit 2022.

Prioritet 4. Ngritja e shkollave të reja, në veçanti në qytet ku numri i nxënësve në klasë është shumë i lartë.

- **NJA1** - Rikonstruktimi i shkollës “Naim Frashëri” nuk është realizuar ende. Bashkia Elbasan ka deklaruar se ky prioritet është i pamundur të përmbushet në këtë mandat pasi kërkon një grant qeveritar, i cili i kalon mundësitë e vetë bashkisë për ta përmbushur atë. Ndërkohë Bashkia ka deklaruar se ajo po zbaton me mbështetjen e Ministrisë së arsimit rikonstruksionin e 2 shkollave të mesme, gjimnazi i përgjithshëm K.Kristoforidhi dhe shkolla e mesme e muzikës.

Prioritet 5. Vendosja e autobuzëve në linjat e njësive administrative Papër, Funar, Shushicë. Publikimi në stacion i orareve të mbërritjes dhe nisjes së autobuzëve. Ky prioritet nuk merret parasysh pasi Transporti sipas Bashkisë realizohet me autobuzë/ taksi private, përveç Nj. Administrative Shushicë e cila mbulohet nga urbani i qytetit.

- Nga monitorimi që i kemi bërë webit të Bashkisë Elbasan, faqes zyrtare në facebook të Bashkisë, faqes personale të Kryetarit në mediat sociale vërejmë se në një pjesë të mirë të publikimeve janë pasqyruar ndërhyrjet në ato zona , të cilat kanë qenë target i prioritetëve.

Vlerësim i thelluar dhe Përfundime

Ajo çfarë mund të prezantojmë në këtë fazë të projektit është se Bashkia ka treguar seriozitet dhe angazhim në përmbushjen e prioritetëve dhe ky fakt reflektohet në përmbushjen e 70 % të prioritetëve të hartuara në kontratën sociale dhe ka në zbatim edhe 30 % të tjera. Me nxitjen e herëpashershme nga organizata TVO por edhe angazhimin e Bashkisë ndaj komunitetit ka një transparencë të shtuar në bërjen publike të çdo iniciative të ndërmarë dhe kjo reflektohet në publikimet që bëhen në rrjetet sociale të Bashkisë.

Gjithashtu TVO NGO duke qenë pjesë e procesit të konsultimeve publike sic ishte dhe takimi I

fundit per diskutimin dhe bërjen transparent të PBAs ka monitoruar takimet që janë zhvilluar në zonat prioritare të kontratës sociale. Është observuar një rritje e përfaqësimit të komunitetit në takime si dhe është kërkuar llogaridhënia nga komuniteti për çdo premtim të dhënë nga Bashkia Elbasan.

Përmbushja e prioriteve të kontratës sociale të Bashkisë Elbasan do të jetë në fokusin e PBA 2022-2024. Fokusi kryesor I këtij buxhetimi afatmesëm, sipas kryebashkiakut është rritja e cilësisë në shërbime për ujitjen e kullimin, sportin, kulturën, bujqësinë, etj.




Raporti i monitorimit për vitin e 2-të të kontratës sociale do të prezantohet brenda muajit Dhjetor tek përfaqesuesit e Bashkisë Elbasan dhe përfaqesuesit e Njësive administrative, nga ku dolën prioritet e kontratës sociale.


Rekomandime

- Prioritetet e papërmbushura të kontratës sociale të bëhen pjesë e planit buxhetor të vitit 2023;
- Furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë nga masa 70 % që është aktualisht të bëhet në masën 100 %;
- Të rishikohet ofrimi i transportit publik për NjA e zonave rurale të cilat nuk e aksesojnë dot atë;
- Të konsiderohet përmbushja e prioriteve të kontratës sociale edhe nga këndvështrimi gjinor duke i dhënë më shumë përparësi realizimit të atyre prioriteve që kanë një numër të madh përfituesish gra dhe fëmijë (rikonstruksioni i shkollës Naim Frashëri duke shtuar dhe ambiente sportive etj).
- Rritje e kërkesës së llogarisë ndaj kompanisë të pastrimit të mbetjeve në Elbasan.
- Të shikohen me përparësi shqetësimet e ngritura nga komuniteti gjatë takimeve të fundit të realizuara në muajin Shtator dhe Tetor 2022 përsa i përket shërbimeve publike në NjA të zonave rurale.

Aneke

Aneks 1. Paraqitja grafike e rezultateve





Aneks 2. Kontrata Sociale – Bashkia Elbasan

PRIORITETET E KOMUNITETIT
BASHKIA ELBASAN
KORRIK 2021

Prioritet 1: Hartimi i nje projekti dhe me pas financimi per rehabilitimin i rrugës kryesore që lidh bashkinë me njësitë administrative dhe vijimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për secilën njësi.

- **NjA Funar** – Projektimi i rruges kryesore që lidh njesinë me Bashkinë Elbasan
- **Nja Funar** - Rikonstruktimi i urës së fshatit
- **NjA Shushice** - Rikonstruktim i rrugës së Shelcanit
- **NjA 1** - Pajisja me ndriçim në rrugën kryesore
- **NjA 1** - Rehabilitimi i rrugës së ish konservimit.
- **NjA 1** - Rikonstruktimi i rruges se varrezave ne lagjen Emin Matraxhiu.

Prioritet 2. Adresimi me prioritet i furnizmit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për secilën prej njësive vijuese.

- **Në lagjen 28 Nëntori** Ka pallate që kane 2 ore ujë të pijshëm ne dite, shtimi i fashes se orarit.
- **NJA Funar** – Rikonstriksioni i shpërndarjes së ujit të pijshëm.
- **NjA Shirgjan** – Ka dite qe mungon uji per vaditje, sigurimi ne menyre te vazhdueshme i ujit për vaditje.

Prioritet 3. Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas njësive.

- **NjA Papër** - Mungojnë koshat për grumbullimin e plehrave.

- **NjA Funar** - Mungojnë koshat e plehrave.
- **NjA 1** - Kosha plehrash ka por janë larg vendeve të banimit.
- **NjA 1** - Të zgjidhet problemi i pastrimit ditët e festave, pasi punëtorët nuk pastrojnë dhe rritet ndotja.

Prioritet 4. Ngritja e shkollave të reja, në veçanti në qytet ku numri i nxënësve në klasë është shumë i lartë.

NjA 1 - Rikonstruktimi i shkollës Naim Frasheri

Prioritet 5. Vendosja e autobuzëve në linjat e njërive administrative Papër, Funar, Shushicë. Publikimi në stacion i orareve të mbërritjes dhe nisjes së autobuzëve.